

Hapet thirrja për bursa në kuadër të programit Erasmus + për personelin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Petroleum-Gas University në Ploiesti, Rumani, për të marrë pjesë në Javën Ndërkombëtare në periudhën qershor - korrik 2023.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për personelin me kohë të plotë të UT-së për trajnim në Petroleum-Gas University në Ploiesti, Rumani, për të marrë pjesë në Javën Ndërkombëtare në data 24 – 28 prill 2023.

<https://www.upg-ploiesti.ro/en>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e personelit me kohë të plotë për trajnim;

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 + 2 ditë;

Bursat përfshijnë:

-Kompensim ditor (140 Eur / ditë);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë për trajnim:

- CV + Lista e publikimeve (për personelin akademik), (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Certifikata e gjuhës së huaj;

- Vetëdeklarim nëse keni kryer apo jo më parë një mobilitete Erasmus+ (nëse po, ku, duke specifikuar mobilitetet e kryera, emrin e universitetit dhe periudhën e shkëmbimit);

- Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx

*Plani i Mobilitetit për personelin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: **19 Prill 2023, ora 12:00.**

Dokumentat duhen dorëzuar të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!